

PËR: Z. RAMUSH HARADINAJ, KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CC: Z. BAJRAM HASANI, MINISTËR I TREGTISË DHE INDUSTRI SË  
Z. BEDRI HAMZA, MINISTËR I FINANCAVE  
Z. GEM MALOKU, KRYESUES I KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR  
NGA: ARDIANA BUNJAKU, DREJTORESHË EKZEKUTIVE E SHKÇAK  
LËNDA: REAGIM I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE TË ÇERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE TË KOSOVËS  
(SHKÇAK) NË UA 02/2018  
DATA: 06 SHKURT 2018

I nderuari Z. Kryeministër Haradinaj,

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK) përmes kësaj letre reagon në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për mënyrën dhe metodat e verifikimit të përbushjes së kriterëve për përcaktimin e statusit të investitorit strategjik.

Më konkretisht reagimi i SHKÇAK është i fokusuar në Nenin 3, paragrafi 1.5:

*"Institucion auditues kredibil – ndërmarrje e licencuar për të ofruar shërbime të auditimit financiar në të paktën dy shtete ku të paktën njëri nga këto shtete është anëtar i Bashkimit Evropian."*

Së pari shprehim bindjen tonë se emërtimi "Institucion auditues kredibil" nuk është adekuat pasi që në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përdoret termi „Firmë auditimi“ apo „Auditor“

Përmes termit të përdorur në këtë UA bëhet diskriminim i qartë i firmave vendore të auditimit të cilat me vet faktin se janë të licencuara sikurse edhe firmat e jashtme të auditimit, kanë kredibilitet për kryerjen e auditimeve, por që me këtë udhëzim ato po përjashtohen pa asnjë bazë.

Ligji Nr. 04L/014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në mënyrë të qartë i përcakton kriteret për licencim të auditorëve vendor dhe atyre të huaj, firmave vendore të auditimit dhe firmave të huaja, dhe me vet faktin e licencimit të tyre nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) konform kriterëve të përcaktuara ligjore ato janë në pozitë të barabartë për ofrimin e shërbimeve në tregun vendor.

Prandaj, besojmë se të gjitha firmave të auditimit licencuara nga KKRF duhet t'u ofrohet mundësi e barabartë e konkurimit.

Në fund, ne si Shoqatë Profesionale dëshirojmë të shprehim bindjen tonë se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të shpreh vullnetin e mirë për të intervenuar në korigjimin e paragrafit të mësipërm me qëllim të trajtimit të barabartë të auditorëve dhe firmave të auditimit në Kosovë.

SHKÇAK e shpreh gatishmërinë për një takim në të cilin do të ofroj sqarime të nevojshme nëse ju e konsideroni të nevojshme

Me respekt,

Ardiana Bunjaku  
Drejtoreshë Ekzekutive

